

PËRGATISNI ÇDO GJË TË NEVOJSHME



FINANCAT E FAMILJES

MESAZH NGA PRESIDENCIA E PARË

Të Dashur Vëllezër dhe Motra:

Shenjtoret e ditëve të mëvonshme janë këshilluar për shumë vite për t'u përgatitur për fatkeqësi duke patur pak para mënjanë. Bërja e kësaj rrit pa masë sigurinë dhe mirëqenien. Çdo familje ka një përgjegjësi për të siguruar për nevojat e saj në masën që është e mundur.

Ne ju inkurajojmë kudo që jetoni në botë të përgatiteni për situata fatkeqësie duke parë gjendjen tuaj financiare. Ne ju nxisim të jeni modestë në shpenzime, të disiplinoni veten në blerjet dhe të shmangni borxhet. Shlyeni borxhin sa më shpejt që mundeni dhe çlirohuni nga kjo vartësi. Kurseni rregullisht pak para që pak nga pak të krijoni një rezervë financiare.

Nëse i keni shlyer borxhet dhe keni një rezervë financiare, qoftë edhe të vogël, ju dhe familja juaj do të ndiheni më të sigurtë dhe do të gëzoni një paqe më të madhe në zemër.

Zoti ju bekoftë në përpjekjet lidhur me financat e familjes.

Presidencia e Parë



BAZAT E FINANCËS SË FAMILJES

PAGUANI TË DHJETËN DHE OFERTAT



Financa e suksesshme familjare fillon me pagimin e një të dhjete të ndershme dhe me dhënien e një oferte bujare agjërimit. Zoti ka premtuar të hapë pragjet e qiellit dhe të derdhë bekime të mëdha mbi ata që paguajnë besnikërisht të dhjetën dhe ofertën (shih Malakia 3:10).

SHMANGNI BORXHIN



Të shpenzosh më pak para se sa fiton është thelbësore në sigurinë tuaj financiare. Shmangni borxhin, duke përjashtuar blerjen e një shtëpie modeste apo pagesën për arsim apo nevoja të tjera jetike. Kurseni para për të blerë çka ju nevojitet. Nëse jeni në borxh, shlyejeni sa më parë që është e mundur.

PËRDORNI BUXHET



Mbani një regjistër për shpenzimet tuaja. Regjistroni dhe rishikoni çdo muaj të ardhurat dhe shpenzimet. Përcaktoni si të pakësoni shpenzimet për gjëra jo të rëndësishme.

Përdoreni këtë informacion për të formuar një buxhet të familjes. Planifikoni çka do t'i jepni si donacione për Kishën, sa do të kurseni dhe çfarë do të shpenzoni për ushqim, strehim, elektrik, ujë, telefon, transport, veshje, sigurime, e kështu me radhë. Disiplinoni veten për të jetuar brenda planit tuaj buxhetor. (Shih Tabelën e Buxhetit në faqen pra.)

KRIJONI NJË REZERVË



Pak nga pak krijoni një rezervë financiare dhe përdoreni atë vetëm për emergjenca. Nëse kurseni rregullisht pak para, ju do të befasoneni sa shumë janë grumbulluar gjatë kohës.

MËSONI ANËTARËT E FAMILJES



Mësojuni anëtarëve të familjes parimet e menaxhimit financiar. I përfshini ata në krijimin e një buxheti dhe në caktimin e objektivave financiare të familjes. Mësoni parimet e punës së palodhur, nikoqirllëkut dhe të kursimit. Theksoni rëndësinë e arritjes të sa më shumë arsimimi që është e mundur.

TABELA E BUXHETIT

BUXHETI PËR _____

(muaj/vit)

Të ardhura	Të planifikuara	Të realizuara
Paga/Rroga (minus taksat)		
Të ardhura të tjera		
Të ardhura gjithsej		

Shpenzime	Të planifikuara	Të realizuara
Të dhjetat dhe ofertat		
Kursime		
Ushqim		
Hipotekim apo qira		
Shërbime		
Transport		
Pagesa borxhi		
Sigurime		
Shëndetësore		
Veshje		
Shpenzime shkolle		
Të tjera _____		

Shpenzime gjithsej		
Të ardhura minus shpenzimet		

- Bëni buxhet për një periudhë të caktuar kohe (si javore, dyjavore, mujore).
- Rishikoni rregullisht buxhetin tuaj.

*Shihni në Internet
www.providentliving.org
për më shumë informacion mbi financat familjare.*

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME